

REGJISTRI KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE - TETOR 2024

NR. RENDOR	DATA E KËRKESËS	OBJEKTI I KËRKESËS	DATA E PËRGJIGJES	PËRGJIGJE	MËNYRA E PËRFUNDIMIT TË KËRKESËS	TARIFA
1	02.10.2024	Kërkesë për informacion	15.10.2024	<p>Në përgjigje të shkresave Tuaja, ju sqarojmë edhe njëherë se: Lidhur me kërkesat tuaja, kjo shkresë ka të njëjtën përmbajtje me shkresën tuaj të mëparshme. Në vijim, sikurse ju kemi informuar AZHT, disponon të gjitha vendimet që janë miratuar nga KKT, prej tetorit të vitit 2015 e në vijim, të cilat janë të aksesueshme për të gjithë subjektet, në adresën zyrtare të AZHT: https://azht.gov.al, në rubrikën "Vendime KKT". Gjithashtu, për sa i përket dokumentacionit të pronësisë së pasurive të cilat kanë qenë pjesë e ketyre projekt propozimeve ju kemi sqaruar se referuar nenit 64 të ligjit Nr.9154 datë 06.11.2003 "Për Arkivat", ju si kerkues nuk bëni pjesë në rrethin e trashëgimtarëve dhe gjithashtu nuk jeni institucion shtetëror i cili gëzon të drejtën për t'u sherbyer me dokumentacionin që ju keni kërkuar referuar kërkesës suaj. Po ashtu, në vijim të përgjigjes së shkresës suaj ju kemi bërë me dije se referuar Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen personale të të dhënave" i ndryshuar, dokumentacioni që ju kerkoni duke përmendur dokumentacionin e pronësisë si dhe kontratën e sipërmarrjes, nuk mund t'ju vendoset në dispozicion nga ana jonë, pasi përmbajë të dhëna personale.</p> <p>Për sa më sipër, pavarësisht se kopjet e vendimeve që ju kerkoni në shkresat tuaja janë lehtësisht të aksesueshme në faqen zyrtare të AZHT-së, po ju vendosim në dispozicion një kopje të vendimeve si dhe të dokumentacionit që i shoqëron...</p>	E plotë	nuk ka

2	03.10.2024	Kërkesë	08.10.2024	<p>Në përgjigje Suajës, ju sqarojmë: Sikurse jeni në dijeni, AZHT kryen funksionin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe në përputhje me VKM-së Nr. 725, datë 02.09.2015 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, e cila ka kompetencën për të pranuar, përgatitur dhe administruar dokumentacionin tekniko-ligjor që shqyrtohet dhe miratohet në mbledhjet e KKT-së, ndërkohë autoriteti përgjegjës për vendimmarrjen për leje zhvillimi dhe ndërtimi, apo ndryshimet e tyre, është vetëm KKT.</p> <p>Në vijim, në pikën (1) gërma (b) të Nenit 9 “Përgjegjësitë e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit” të Ligj Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e Territorit” i ndryshuar, citohet</p> <p>Për sa më sipër, lutemi t’i drejtoheni AKPT, si autoriteti përgjegjës për bashkërendimin e procesit të hartimit dhe rishikimit të Dokumentave të Planifikimit që ndërmerren në nivel qendror dhe vendor, referuar dispozitës sipërcituar si dhe dispozitave vijuese të Ligj Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, për vendosjen në dispozicion të informacionit të kërkuar nga ana juaj</p>	E plotë	nuk ka
3	11.10.2024	Kërkesë për informacion	16.10.2024	<p>Në përgjigje të shkresës Suaj, ju informojmë se: Agjencia e Zhvillimit të Territorit e cila aktualisht kryen funksionin e Sekretariatit Teknik të KKT-së është krijuar me VKM-së Nr.725, datë 02.09.2015 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar. Në mëshjtjetje të VKM-së sipërcituar, kjo Agjencia ka kompetencë <i>pranimin, përgatitjen dhe administrimin e dokumentacionit që shqyrtohet në mbledhjet e KKT-së</i>, me qëllim miratimin e lejeve të zhvillimit/ndërtimit nga KKT....</p> <p>Në vijim,lidhur me kërkimin tuaj për vënie në dispozicion të këtyrevendimmarrjeve,ju informojmë se ato janë të aksesueshme,së bashku me hartën e planvendosjes që i bashkëlidhet,në adresën zyrtare të AZHT: https://azht.gov.al , në rubrikën "<i>Vendime KKT</i>" .</p>	E plotë	nuk ka

4	21.10.2024	Kërkesë	01.11.2024	<p>Në përgjigje të shkresës Suaj, ju sqarojmë si më poshtë: Sikurse jeni në dijeni,KKT në mbledhjen...ka miratuar lejen...Në vijim,pranë AZHT, është protokolluar aplikimi...,miratuar me vendimin...,i cili është në proces konfirmimi. Për sa më sipër,bashkëlidhur gjeni kopje të projektit të miratuar..</p>	E plotë	nuk ka
5	22.10.2024	Kërkesë për informacion			Në proces	Nuk ka
6	25.10.2024	Kërkesë	04.11.2024	<p>Në përgjigje të shkresës Suaj, ju bëjmë me dije se: AZHT, në mbështetje të në përputhje me Ligj Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, VKM-në 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, si dhe VKM-së Nr. 725, datë 02.09.2015 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, është institucioni i cili ushtron funksionet e Sekretariatit Teknik të KKT-së dhe si e tillë, ka si kompetencë pranimin, përgatitjen dhe administrimin e dokumentacionit tekniko-ligjor që shqyrtohet në mbledhjet e KKT-së, me qëllim miratimin e lejeve të zhvillimit dhe/apo ndërtimit, monitorimin dhe lëshimin e çertifikatës së përdorimit për lejet e ndërtimit të cilat miratohen nga KKT, si dhe kontrollin e konformitetit për zhvillimet e propozuara me rastet përjashtimore. Në vijim, nga verifikimi i kryer, rezultoi se.... Për sa më sipër, në zbatim të VKM-së Nr.408, datë 13.5.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit ", i ndryshuar si dhe Vendimit Nr. 12, datë 27.02.2019 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për miratimin e lejeve të zhvillimit/ndërtimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit, në njësitë që i përkasin Sistemeve Urban (UB), Bujqësor (B) dhe Natyror (N)”, i ndryshuar, ju orientojmë të aplikoni në sistemin elektronik e-lejet pranë Bashkisë Shijak, si autoriteti kompetenti cili vetëm pas shqyrtimit të aplikimit Tuaj dhe dokumentacionit tekniko-ligjor i drejtohet për mendim institucionit tonë në zbatim të dispozitave të sipërcituara, në fuksion të miratimit të lejes përkatëse për objektin që ju dëshironi të ndërtoni.</p>	E plotë	nuk ka

7	30.10.2024	Kërkesë për leje ndërtimi	04.11.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës Suaj, Ju bëjmë me dije se: sqarojmë se Agjencia e Zhvillimit të Territorit kryen funksionin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe në përputhje me VKM-së Nr.725, datë 02.09.2015 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, e cila ka kompetencën për të pranuar, përgatitur dhe administruar dokumentin tekniko-ligjor që shqyrtohet në mbledhjet e KKT-së, ndërkohë autoriteti përgjegjës për vendimmarrjen për leje zhvillimi dhe ndërtimi, apo ndryshimet e tyre, është vetëm Këshilli Kombëtar i Territorit.</p> <p>Në funksion të përmbushjes së kompetencave të saj, pas verifikimit, rezulton se projekti të cilës kërkuesi i referohet përfshihet në Planin e Detajuar të Zonës me Rëndësi Kombëtare(PDZRK) miratuar me Vendimin.....</p>	E plotë	nuk ka
---	------------	---------------------------	------------	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	---------	--------